



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

RELACION TEKNIK

(KONTRATA NR:12)

Mirembajtje me performance rruga: "**Bajram Curri – Valbonë, U.Bujanit - Q.Morinë (doganë) ,Sopot-Kërnajë, Q.Mejdan -Tropojë-Bucaj**"

Përshkrim i përgjithshëm.

Aksi rrugor "**B.Curri - Valbone**" **28 km** është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetin **B.Curri** me njesine administrative Margegaj ,zonen turistike te **Valbones** , zonen e Alpeve dhe ne perspective me Malin e Zi. Segmenti klasifikohet i kategorisë E si rrugë interurbane dytësore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me bankina 2x75 cm te paasfaltuara. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren të theksuar malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor "**Ura e Bujanit – Qaf Morin**" (*dogane*) (**17.3 km**).është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh rrethin e Tropojes me Kosoven e ne vazhdimesi me rrugen e Kombit. Segmenti klasifikohet i kategorisë C si rrugë interurbane dytësore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me bankina 2x75 cm te paasfaltuara. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon nje pjese ne rrafshin e Bujanit te Tropojes ne terren fushor, ndersa pjesa tjeter nëpër një terren malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor "**Qafe Mejdani – Tropoje - Bucaj**" (**7.6 km**).është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh Njesine administrative Tropoje dhe fshatin Bucaj me rrugen B.Curri - Gjakove. Segmenti klasifikohet i kategorisë F si rrugë lokale , me një karrexhatë,me dy korsi nga me gjatsi **2.7 km** me nga nje sens levizje dhe me nje korsi me nje sens levizje nga Ttropoja ne Bucaj ,me bankina 50 cm te pa asfaltuara. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës per pjesen Qaf Mejdani - Tropoje është 6 m ndersa sementi Tropoje –





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Bucaj 4.3 ml . Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon pjesa e pare ne fushen e Tropojes ndersa pjesa tjetër nëpër një terren të theksuar malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor "**Sopot - Kerrnajë**" **6.5 km** është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh Fshatin Kerrnaj me rrugen B.Curri - Gjakove. Segmenti klasifikohet i kategorisë F si rrugë lokale , me një karrexhatë, me nje korsi me nje sens levizje,me bankina 50 cm te paasfaltuara. Gjerësia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 4.3 ml . Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren të theksuar malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje dimërore.

Me poshte paraqitet tabela me segmented rrugore qe perbejne kete kontrate:

Nr.	Segmenti rrugor	Gjatësia (km)	KOORDINATA E PIKES SE FILLIMIT (WGS 84)		KOORDINATA E PIKES SE MBARIMIT (WGS 84)	
			N	E	N	E
1	B.Curri - Valbonë	26.5	42°22'01.6"	20°04'35.3"	42°25'33.5"	19°52'13.5"
2	U.Bujanit - Q.Morinë (Doganë)	17.3	42°19'41.7"	20°04'47.5"	42°24'45.5"	20°13'19.6"
3	Q. Mejdani - Tropojë e Vjetër - Bucaj	7.6	42°23'00.3"	20°09'01.9"	42°25'31.4"	20°10'04.0"
4	Sopot - Kerrnajë	6.4	42°22'35.0"	20°07'25.9"	42°24'30.3"	20°07'11.3"
Shuma (km):		57.8				

Kushtet e inspektimit.

Sot me datë 28.03.2024, në zbatim të Urdhërit të Brëndshëm Nr.113 datë 26.03.2024, kemi bërë inspektimin në terren të segmenteve rrugore "**Bajram Curri – Valbonë, U.Bujanit - Q.Morinë (doganë) ,Sopot-Kërnajë, Q.Mejdani -Tropojë-Bucaj**". Bazuar në urdhërin e brëndshëm për përlllogaritjen e fondit limit, si objektivi i inspektimit tonë ka qënë konstatimi i gjëndjes aktuale të segmenteve rrugore në fjalë dhe përcaktimi i nevojave për punime rehabilitimi që do ketë ky segment gjatë 4 viteve të ardhshme (2025-2029) , me qëllim hartimin e preventivave për përlllogaritjen e fondit limit të kontratës së ardhshme. Theksojmë se inspektimi jonë është vetëm i karakterit vizual.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Përshkrimi i situatës aktuale të segmenteve rrugore .

Gjatë zbatimit të kontratës së mëparshme të mirëmbajtjes vihet re një ndërhyrje kryesisht në riparime të pjesshme të shtresave asfaltike të përqendruara në segmentet rrugore "Bajram Curri – Valbonë, U.Bujanit - Q.Morinë (doganë) ,Sopot-Kërnajë, Q.Mejdan -Tropojë-Bucaj". Gjithashtu evidentohen dhe riparimi i disa mureve apo pusetave të tombinove. Ka një përmirësim të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe horizontale, duke shtuar edhe shumë elementë që nuk kanë qënë më përpara si shevrone apo përvijues anësorë. Gjithashtu rezulton edhe një shtim i konsiderueshëm i barrierave mbrojtëse metalike në kete segment. Por duke u nisur nga fakti se aksi rrugor kalon nëpër një terren shumë të theksuar malor, dhe çdo vit përballlet me kushte të vështira atmosferike, vërehet së aksi ka nevoja të metejshme në shtimin apo përmirësimin e të gjithë elementeve rrugore që përmendëm më sipër, pjesë të cilën do ta trajtojmë më hollësisht në pikat e mëposhtme.

Evidentimi i problematikave dhe propozimi për zgjidhjen e tyre.

● Segmenti rrugor “ **B.Curri - Valbone** ” **28 km**. është segment i plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjëndje mesatare, por ne disa km. ky segment rrugor ka nevoja të mëtejshme për përmirësimin e shtresave asfaltike. Në disa zona të cilat janë të përcaktuara më hollësisht në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar riveshje me asfalt, pasi dallohen qartë dëmtimet apo tendenca për një agravim të mëtejshëm gjatë viteve të ardhshme, vendosjen e mbrojtëseve metalike te reja duke zëvendësuar edhe nje pjese te cilat jane mjaft te demtuara. Duke para vershimet e koheve te fundit eshte mendur ndertimi i nje tombine Ø 1000 ne km 12 Gjithashtu kemi parashikuar edhe ndërtimin në disa zona të kuletave anesore me bordurë, pasi ka shume zona ku ato mungojnë, duke sjellë si pasojë vërshimin e ujërave brinjë buzës së asfaltit dhe duke u bërë shkak për dëmtimin e tij. Segmenti “**B.Curri - Valbone** ” **28 km** është një segment që shtrihet në një terren malor dhe me mirëmbajtje dimërore. Në këtë segment rezulton se është ndërhyrë në shtimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, si dhe riparime të mureve apo pusetave të tombinove. Pavarësisht kësaj, gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit që kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja te dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkeqsimin e situatës gjatë viteve të ardhshme. Vendodhjet e tyre janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve që janë plotësuar në terren. Në disa vende, aty ku është parë e nevojshme për të





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

ruajtur konturin e asfaltit nga ujërat e skarpatave, është menduar ndërtimi i kunetave me bordure, pozicionet e të cilave janë të përcaktuara në tabela. Gjithashtu është menduar dhe ndërhyrja në disa pozicione të favorshme për rrëshqitje, ndërhyrja do të bëhet me anë të zërit "Rrafshim skarpate". Përveç këtyre punimeve që përmendëm më lart janë përcaktuar edhe punime të tjera më të vogla të shpërndara pothuajse gjatë gjithë gjatësisë së aksit me qëllim rritjen e sigurisë rrugore dhe përgatitjen në avancë për situatat e mundshme problematike që mund të shfaqen gjatë katër viteve të ardhshme. Duke parë rreshqitjen e kurve dhe inerteve nga skarpatat në disa vende kemi menduar për veshjen e tyre me rrjete. Megjithatë ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse metalike, përsëri kemi evidentuar nevojën që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndarjes së punimeve.

Në lidhje me vijëzimet, kemi menduar që të gjitha pjesët e riveshura të vijëzohen sipas parametrave të vijëzimit ekzistues nepermjet vijave me boje bikomponente me gjerësi 15cm. Vendodhjet përkatëse janë të specifikuar në tabelat e shpërndarjes së volumeve.

- Segmenti rrugor "*Ura e Bujanit – Qaf Morine (dogane)* " (17.3 km).. është segmenti i plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjëndje mesatare, por në disa km. ky segment rrugor ka nevojën të mëtejshme për përmirësimin e shtresave asfaltike. Në disa zona të cilat janë të përcaktuara më hollësisht në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar riveshje me asfalt, pasi dallohen qartë dëmtimet apo tendenca për një agravim të mëtejshëm gjatë viteve të ardhshme, vendosjen e mbrojtësive metalike të zëvendësojmë me të reja. Gjithashtu kemi parashikuar edhe ndërtimin në disa zona të kunetave anësore me bordurë, pasi ka shumë zona ku ato mungojnë, duke sjellë si pasojë vërshimin e ujërave brinjë buzës së asfaltit dhe duke u bërë shkak për dëmtimin e tij. Një problematikë që vlen të përmendet është dëmtimi i qemerit dhe ballit të ures në km 6 të këtij segmenti (degezimi I Begaje). Nga vëzhgimi jonë na rezulton se balli i ures është demtuar në një gjatësi rreth 2 m në anën e brendshme të saj, duke krijuar një shkeputje të murit me lartësi rreth 3 m, balli është demtuar në anën veriore dhe ura ka një hapësirë 3m. Për këtë arsye me anë të punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar një rikonstruksion të saj, duke përfshirë ndërtimin e murit të ri në ballin e demtuar. Një problematikë tjetër është degradimi i murit prites nga km 13 – 16. Në disa km ka demtime të shtresës asfaltobetone.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Segmenti rrugor "*Ura e Bujanit – Qaf Morine*", është një segment që shtrihet në një terren kodrinor - malor dhe me mirëmbajtje dimërore. Në këtë segment rezulton se është ndërhyrë në shtimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, si dhe riparime të mureve apo pusetave të tombinove. Pavarësisht kësaj, gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit që kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja të dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkeqsimin e situatës gjatë viteve të ardhshme. Vendodhjet e tyre janë të përcaktuara në tabelat e shpërndarjes së punimeve që janë plotësuar në terren. Në disa vende, aty ku është parë e nevojshme për të ruajtur konturin e asfaltit nga ujërat e skarpatit, është menduar ndërtimi i kunetave me bordure, pozicionet e të cilave janë të përcaktuara në tabela.. Gjithashtu një mur butobetoni prites me $h = 1.5$ m kemi menduar ta ndërtojmë nga km 13 – 16 për të mundur disiplinimin e inerteve dhe ujrave në rrugë. Përveç këtyre punimeve që përmendëm më lart janë përcaktuar edhe punime të tjera më të vogla të shpërndara pothuajse gjatë gjithë gjatësisë së aksit me qëllim rritjen e sigurisë rrugore dhe përgatitjen në avancë për situatat e mundshme problematike që mund të shfaqen gjatë katër viteve të ardhshme..Megjithëse ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse metalike, përsëri kemi evidentuar nevoja që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndarjes së punimeve.

Në lidhje me vijëzimet, kemi menduar që të gjitha pjesët e riveshura të vijezen sipas parametrave të vijëzimit ekzistues nepermjet vijave me boje bikomponente me gjerësi 15cm.

- Segmenti rrugor "*Qafe Mejdani – Tropoje - Bucaj*" (7.6 km).është segment i plotësuar kryesisht me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Rezulton se momentalisht është ndërhyrë pjesërisht në përmirësimin e shtresave rrugore. Shtresat asfaltike të rrugës janë në gjëndje mesatare, por në disa km. ky segment rrugor ka nevoja të mëtejshme për përmirësimin e shtresave asfaltike. Në disa zona të cilat janë të përcaktuara më hollësisht në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar riveshje me asfalt, pasi dallohen qartë dëmtimet apo tendenca për një agravim të mëtejshëm gjatë viteve të ardhshme,vendosjen e mbrojtëseve metalike të zëvendësojmë me të reja.

- Segmenti rrugor "*Sopot - Kernajë*" 6.5 km.. është një segment që shtrihet në një terren malor dhe me mirëmbajtje dimërore. Në këtë segment rezulton se është ndërhyrë në shtimin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, si dhe riparime të mureve apo pusetave të tombinove. Pavarësisht kësaj, gjatë inspektimit kemi evidentuar disa pjesë të asfaltit që





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

kanë nevojë për riveshje apo që shfaqin shënja të dukshme të cilat mund të ndikojnë në përkeqsimin e situatës gjatë viteve të ardhshme..Megjithëse ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse metalike, përsëri kami evidentuar nevoja që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndarjes së punimeve.

Në lidhje me vijëzimet, rezulton se pjesa më e madhe e aksit është me vizim relativisht në gjendje të mire dhe është menduar që ai të ribehet kryesisht në zonene e qendrave të banuara për të rritur sigurinë në rrugë. Standarti i përdorur masivisht për rrugët e kategorisë F për vijëzime është : 2 vijat anësore dhe vija e mesit janë të realizuara me vijë me trashësi 15cm. Të njëjtin standart kemi ndjekur edhe në parashikimin e vijëzimeve që do realizohen katër vitet e ardhshme. Vijëzimet janë llogaritur nëpër zona të banuara, nëpër shkolla apo institucione dhe nëpër pjesë të rrugëve që do të nënshtrohen riveshjeve. Vendodhjet përkatëse janë të specifikuar në tabelat e shpërndarjes së vullmeve.

Parashikimi i punimeve të rehabilitimit.

Për të lehtësuar mënyrën e paraqitjes së shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit, kemi menduar që sasitë e këtyre punimeve të paraqesim fragmentuara dhe të grupuara në segmente prej 1 kilometri. Përzgjedhja e zërave të punimeve të rehabilitimit është bërë në bazën e eksperiencës që kemi në kontratat e mëparshme duke evidentuar zërat që kanë rezultuar me efektivitet më të lartë gjatë kontratave të shkuara, si dhe shtimin e disa zërave të rinj të cilët na kanë rezultuar të duhur për përdorim në situata të caktuara.

Volumet e punimeve të parashikuara për një periudhë 4 vjeçare sipas segmenteve respektive, janë paraqitur në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit periodike.

Tabela përmbledhëse e kategorisë së punimeve të rehabilitimit është :

Nr.Ana	Përshkrimi i punimit	Njesia	Sasia
	1. PUNIME GERMIMI		





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.119/a	Germim shkambi i coptuar me ekskavator 0.5 m ³ , shkemb, ne themele gjeresi ~2 m, me shkarkim ne toke,	m3	3715
3.95/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	590
3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	3775
3.161/2	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 0.25m ³	m2	2000
2. PUNIME SHITESASH			
3. 197	Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri	m2	2320
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	180
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	270
3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	2070
3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	29870
3.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	20
3. ANALIZA TEKNIKE			
3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri	m2	2320
3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	32190
4. PUNIME BETONI E BETONARMEJE			
3. 244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	573
3. 235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur	m3	80
5. PUNIME HEKUR BETONI 3			
3. 287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	0.6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3. 288	F V hekur betoni i zakonshem $\varnothing > 12\text{mm}$	ton	0.7
	6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT +KANALIZIME		
3. 323	Mur guri mbajtes e themele, Ilaç çimento M50	m3	88
3. 396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	80
3. 332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	130
3. 405	Prishje struktura prej guri	m3	56
3. 366	Tombino me tuba betoni $\varnothing 800$, mbi shtrese betoni	ml	16
	7. PUNIME TE NDRYSHME		
3. 618	FV Bordura betoni 20x35 cm	ml	1760
	8. D. SINJALET DHE PAJISJET SHTESE, NGADALSUESIT E SHPEJTESISE		
3.948/1	F.v.kurrize artificiale h =5cm	copë	10
3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	15500
3. 953	FV tabela rrugore treguese 150x40cm	copë	12
3. 955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	32
	11. TE NDRYSHME ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA		
3.921/1	F.v. Tabele katrore normal me A=60	copë	38
3.936/1	F.v. Tabela trekendore normal me A = 90	copë	22
3.935/1	F.v. Tabele rrethi "ndalim" normal me D = 60	copë	30
3.933/1	F.v. Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30	copë	12
3.941/1	F.v. Pervijues normal anesor	copë	120



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.941/3	F.v. Pervijues modulare te kthesave (teke)	copë	42
3.941/4	F.v. Pervijues modulare te kthesave (qyfte)	copë	38
3.941/5	F.v. Pervijues kthese e ngushte ose e forte(ne forme T)	copë	38
3.186	F.V guardrail- H1 anesore me 2 valz.e ne 1 ane , W3	ml	730
3. 165	Fuge me gome speciale me kanal te gjere ne ura	ml	14

Foto nga inspektimi në terren.

Gjatë inspektimit në terren janë fotografuar dhe disa nga problematikat aktuale të akseve rrugore. Më poshtë fotot e realizuara në terren :

GRUPI I PUNËS :